



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

**AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/ AGENCY  
OF GENDER EQUALITY**

---

**FTESA PËR SUBVENCIONIM PËR ORGANIZATAT JO QEVERTARE 2024**

**1. Ftesë**

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) rishpallë thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të organizatave jo qeveritare (OJQ), që kontribuojnë në fuqizimin e grave me aftësi të kufizuar, gratë nga minoritetet etnike Roma, Ashkali, dhe Egjiptian, nënave vetëushqyese, dhe moshat e treta. Përmes mbështetjes synojmë të përkrahim projekte të organizatave më përvojë të dëshmuar në punën me këto grupe të marginalizuara. Kjo mbështetje është në kuadër të Objektivit Specifik 1.2. të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2022-2024, i cili synon Sigurimin/avancimin e qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime. Projektet e përkrahura duhet të kenë fokusin në fuqizimin e rolit në shoqëri përmes adresimit të kërkesave specifike; informim publik për nevojat e grupeve specifike; dhe/apo ngritje të kapaciteteve të tyre.

**2. Qëllimi**

Qëllimi i mbështetjes së OJQ-ve është shtrirja e impaktit më të gjerë në fuqizimin e rolit të grave dhe vajzave të grupeve të ndjeshme/ të marginalizuara. Konkretisht, përmes kësaj thirrje synojmë që të:

1. Rrisim pjesëmarrjen përmes trajtimit të nevojave dhe informimit rreth të drejtave të garantuara si : qasja në drejtësi dhe qasja në shërbime publike,
2. Fuqizojmë rolin e grave dh vajzave të këtyre grupeve përmes mbështetjes se iniciativave te tyre, si dhe për të luftuar diskriminimin dhe stereotipet,
3. Ngrisim kapacitetet e këtyre grupeve në fusha specifike, për tejkalimin e sfidave të adresuara nga ana e tyre.

### **3. Grupet e synuara**

Përfituesit kryesorë të këtyre projekteve duhet të jenë nga grupet në vijim:

1. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara,
2. Gratë dhe vajzat nga minoritetet etnike Roma, Ashkali dhe Egjiptian,
3. Nënmat vetë-ushqyese,
4. Gratë e moshave të treta (mbi 65 vjeçare).

Agjencia për Barazi Gjinore u bënë thirrje për aplikim të gjitha organizatave jo qeveritare, të regjistruara në Republikën e Kosovës mandati i të cilave është i fokusuar dhe profilizuar në këto grupe të marginalizuara. Specifikisht, ftojmë OJQ-të që punojnë drejtpërdrejtë me këto grupe dhe kanë projekte konkrete që i përgjigjen qëllimit të thirrjes, të aplikojnë për këto subvencione. Projektet që kanë qasje ndërsektoriale (përfshijnë më shumë se një prej grupeve të lartëcekura) do të kenë përparësi.

Ftesa për propozime shpallet në ueb faqen e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit <https://abgj.rks-gov.net/> .

### **4. Fushëveprimi**

Në kuadër të thirrjes për mbështetje të këtyre iniciativave, ABGJ fton organizatat joqeveritare që të aplikojnë për realizimin e projekteve në fuqizimin e pjesëmarrjes dhe rolit të tyre në shoqëri; informim publik për nevojat e grupeve të marginalizuara të cekura në pikën 3. dhe/apo ngritje të kapaciteteve të tyre.

### **5. E drejta e aplikimit**

Të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha OJQ-të që:

1. Janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës prej së paku pesë (5) vite para datës së publikimit të thirrjes publike,
2. Kanë së paku dy (2) vite eksperiencë pune të dëshmuar (përmes kontratave, projekteve të realizuara) në fushat e lartpërmendura,

3. Dëshmojnë se kanë ekspertizë profesionale të dëshmuar në fushat e lartpërmendura përmes CV-ve të stafit të angazhuar ( të dëshmuara me kontrata të punës, aktivitetet të realizuar me parë, marrëveshje të shërbimeve).

## 6. Përkrahja financiare

Thirrja për aplikim financohet nga fondet publike të ABGJ-së, specifikisht buxheti i Kosovës për vitin 2024, nga vija buxhetore "Grante dhe Subvencione", në shumën totale 27.920.00 Euro.

- Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 27.920.00 Euro.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që do të ndahet për çdo projekt individual është 5,000.00 Euro, ndërsa shuma maksimale është 15,000.00 Euro.
- OJQ-të mund të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrje me **vetëm me një (1) projekt**.

## 7. Kohëzgjatja e projektit

- Periudha e zbatimit të projektit është gjashtë (6) muaj nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

### 1. Kriteret

#### a. Kriteret e përgjithshme

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- 1.1 Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- 1.2 Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- 1.3 Vërtetim tatimor jo më të vjetër së 3 muaj, ku specifikon se aplikanti nuk ka borxhe të pashlyera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.
- 1.4 Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit; (formulari 13)
- 1.5 Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; (formulari 11)
- 1.6 Të mos jetë në proces të falimentimit apo çregjistrimit të organizatës, të marr nga gjykata Komercciale
- 1.7 Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/ udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. (Formulari 15)

1.8 Në rast se projekti do të implementohet në partneritet, dëshmi/marrëveshje mes partnerëve për përgjegjësitë e secilit partner në projekt. (Formulari 12)

1.9 Kopjen e dokumentit identifikues të aplikuesit .

1.10 Certifikatë që aplikuesi nuk është në hetime

2. Me qëllim të dëshmimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, për paragrafët 1.1, 1.2. të këtij neni, aplikuesi dorëzon certifikatat përkatëse; për paragrafin 1.3 vërtetimin tatimor në emër të aplikuesit i lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, dhe 1.4, 1.5., 1.6 dhe 1.7. aplikuesi nënshkruan dhe dorëzon deklaratat përkatëse.

3. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikuesi nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.

### **b. Kriteret Specifike**

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

1.1. Të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban: a) qëllimin b) Përshkrimin ideor/propozimin ideore për realizimin e aktivitetit, c) objektivat specifike, d) aktivitetet e detajuar, e) kalendarin e realizimit, f) lokacionin e zbatimit të projektit, g) rezultatet e synuara, h) rreziqet dhe qëndrueshmërinë, i) monitorimin dhe vlerësimin e projektit, j) Audiencën se cilës i drejtohet .

1.2. Projekt propozimi duhet të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet për secilin aktivitet të ndërmarrë për realizimin e tij , sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe Manualit për zbatimin e Rregullores 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, duke përshkruar dhe specifikuar në mënyrë të çartë secilin shpenzim brenda linjave buxhetore të propozuar.

1.3. Të dorëzojë të dhëna për stafin/personelin e projektit, akterët e angazhuar, kontraktorët duke specifikuar qartë detyrat e secilit, siguron CV-të e tyre, referenca nga angazhimet e tilla paraprake, së bashku me një deklaratë/parakontratë me secilin që planifikohet të angazhohen për zbatimin e projektit, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare.

1.4. Nëse është e aplikueshme; të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektin për të cilat kërkohet bashkëfinancim.

2. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

3. Agjencia ruan të drejtën për të kërkuar informacione apo dokumente plotësuese sipas diskrecionit të saj për të sqaruar çfarëdo dileme të Komisionit Vlerësues.

4. Aplikanti duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret specifike duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas dispozitave të këtij neni dhe thirrjes publike.

5. Secili nga aplikantët do i nënshtrohet kontrollit administrativë, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme dhe specifike.

*c. Kriteret e vlerësimit nga aspekti përmbajtësor*

Projekt-propozimet do të vlerësohen sipas kriterëve në vijim:

<b>Kriteri</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlerësimi me pikë</b>
Përvoja profesionale	<input type="checkbox"/> A posedon aplikuesi përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara?	20 pikë
Objektivat e qarta	<input type="checkbox"/> A janë objektivat e projektit të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?	25 pikë
Aktivitetet e realizueshme	<input type="checkbox"/> A janë aktivitetet e projektit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme? A janë aktivitetet të ndërlidhura me realizimin e objektivave? A janë aktivitetet të ndërlidhura mes tyre?	25 pikë
Rezultatet e arritshme	<input type="checkbox"/> A janë përcaktuar qartë rezultatet dhe a tregohet se si aktivitetet çojnë në arritjen e rezultateve?	15 pikë
Kosto e arsyeshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A janë kostot e aktiviteteve të propozuara reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?</li> <li>• A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara</li> </ul>	15 pikë

#### **4. Procesi i aplikimit**

Të gjitha organizatat që plotësojnë kriteret për aplikim mund të aplikojnë duke plotësuar formularët në vijim:

1. *Formulari 9* - Formulari i aplikacionit për projekt/program (e detyrueshme)
2. *Formulari 10* - Formulari i buxhetit (e detyrueshme)

3. *Formulari 11* - Formulari i deklaratës për të financimit të dyfishtë (e detyrueshme)
4. *Formulari 12* - Formular i deklaratës se partneritetit (nëse aplikohet)
5. *Formulari 13* - Formulari i deklaratës se projekteve të financuara (e detyrueshme)
6. *Formulari 14* - Deklaratë mbi aktivitetetë përshkruara të programit /projektit (e detyrueshme)
7. Formulari 15- Deklaratë e përshtatshmërisë/pranueshmërisë dhe shmangies së konflikt të interesit.

## **5. Dokumentacioni kualifikues**

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së
2. Certifikatën e numrit fiskal
3. Kopjen e letërnjoftimit te personit qe organizata është e regjistruar.
4. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve)
5. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (obligative)
6. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi
7. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim te dyfishtë nga burimet tjera
8. Deklaratë se OJQ ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore
9. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme
10. Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
11. Të dorëzoj parakontratat së bashku me CV-të e menaxherit të projektit dhe stafit implementues/akterët e angazhuar dhe kontraktorëve.
12. Të dërgojë dëshmi/referenca të implementimit të projekteve/ programeve të ngjashme.

## **6. Dorëzimi i aplikacioneve**

OJQ-të duhet t'i dorëzojnë formularët e plotësuar për aplikim:

Projekt propozimet do të dorëzohen në kopje fizike vetëm nga ora 13:30 – 15:30 Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi "Nëna Terezë" 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, Kati VII, Zyra Nr.711)

Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit: [www.abgj-rks-gov.net](http://www.abgj-rks-gov.net).

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [Fahri.Restelica@rks-gov.net](mailto:Fahri.Restelica@rks-gov.net) dhe [Saranda.Zogaj@rks-gov.net](mailto:Saranda.Zogaj@rks-gov.net)

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

## **7. Afati i fundit për aplikim**

- Afati për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së publikimit të ftesës për propozime nga data 20/05/2024 deri me datë 07/06/2024 në ora 15.30

Aplikacionet e dorëzuara pas mbylljes së afatit nuk do të merren parasysh.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës publike janë të detajuara në Udhëzuesin për Aplikim.